Seminari i Psikanalizës
Fusha Frojdiane në Shqipëri
& Rrethi Lakanian Shqiptar

Transferenca nga Frojdi tek Lacan-i në klinikën me fëmijën dhe adoleshentin

DITA II - 12 Maj 2018 - 9H-15H

Biblioteka Kombëtare

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

Liberté • Égalité • Fraternité
RÉPUBLIQUE FRANÇAISE

AMBASSADE DE FRANCE
EN ALBANIE

ASSOCIATION DE LA FONDATION DU CHAMP FREUDIEN
74, rue d'Assas - 75 006 Paris
Tél : 01 45 48 56 72 – Fax : 01 45 48 79 38

SEMINARI I FUSHES FROJDIANE NE SHQIPERI
Paraqitje e përgjithshme

Seminari do të mbahet nga lektorja e Fushës frojdjane**, Myriam Mitelman** anëtare e Shoqatës Botërore të Psikanalizës (A.M.P.).
Ky cikël seminaresh organizohet nga Sekretariati i Fushës Frojdiane për Europën Lindore.

Sesioni i tretë do të zhvillohet në 11-12 Maj 2018 nga **Myriam Mitelman**, psikanaliste në Strasbourg.

Organizuar nga sekretariati i NLS-Est

Regjistrimet kryhen në adresën elektronike ***seminaret_e_psikanalizes@nyjelakim.net***
Tarifa hyrëse për seminarin – 2500 lekë, për studentët nën 26 vjeç – 1500 lekë.
Për më shumë informacione vizitoni faqen tonë zyrtare ***www.nyjelakim.net***

***SEMINARI I FUSHES FROJDIANE NE SHQIPERI**: 2017-2018*

Sesioni i tretë

Transferenca nga Frojdi tek Lacan-i në klinikën me fëmijën dhe adoleshentin

ARGUMENTI

Në një kuptim të përbashkët, transferenca i referohet zhvendosjes së përfaqësimeve subjektive ndaj personit të terapistit. Pacienti « transferon »; tek personi i terapistit, përfaqësimet tashmë ekzistuese përpara takimit.

Në këtë kuptim, transferimi karakterizon çdo marrëdhënie terapeutike. Frojdi formalizoi rëndësinë dhe shtrirjen e fenomenit të transferencës në kontekstin më specifik të trajtimit analitik dhe vuri në dukje se analisti ishte i ndarë në atë që ai është si një person dhe në atë të cilin ai thërritet për të mishëruar prej pacientit që i flet.

Le të theksojmë këtë aspekt tjetër të transferencës: përvoja psikanalitike e çoi Frojdin në këtë vëzhgim, që pacienti, në vend që të kujtohet, udhëhiqet për të përsëritur me personin e terapistit atë që ai nuk thotë. Freud kishte thënë se çdo gjë që pengon vazhdimin e punës analitike është rezistencë dhe kështu mori në konsideratë dimensionin e rezistencës së transferencës si një pengesë në proçesin e kurimit (trajtimit).

Të gjitha këto karakteristika të transferencës të pozicionuara në këtë mënyrë, nuk bënë që Frojdi të konsideronte « transferencën »; mbi personin e analistit si qendrën e vërtetë të analizës. Shfaqjet e transferencës duhet të shërbejnë vetëm për të kuptuar diçka që luhet diku tjetër, në një « skenë tjetër ». Gjithashtu, Frojdi përfundon duke e konsideruar transferencën si një pengesë të domosdoshme.

Lacan ripërpunoi konceptin e transferencës në tekstet frojdiane, duke hapur perspektiva të reja teorike dhe klinike. Për të ndjekur fijet e këtij ri-përpunimi, do të kthehemi në dy raste klinike të Frojdit, atij të Dorës dhe të homoseksuales së re, raste që Lacan i ka rishqyrtuar dhe riinterpretuar këto në disa rrethana, në veçanti: ajo që na intereson këtu, -për të nxjerrë koordinatat e reja të teorisë së tij të transferencës. Do të përqendrohemi më shumë në dallimin që Lacan vendos midis transferencës imagjinare dhe transferencës simbolike.

Në fillim të viteve 1950, Lacan u përpoq efektivisht të zvogëlonte hegjemoninë e imagjinatës që kryesonte teorinë analitike pas Frojdit, për të nxitur një qasje të bazuar në përparësinë e simbolikes. Ai ka përtërirë dhe ringjallur leximin e tekstit frojdian dhe është ky aksi që do të udhëheqë rileximin e këtyre dy rasteve nga ana jonë.

Kjo çështje mund të jetë me interes për çdo mjek, psikolog, terapist, punonjës social, sepse, siç përmendëm në fillim, transferenca është e natyrshme në çdo marrëdhënie kujdesi. Konceptet psikanalitike, larg të qenit objekte abstrakte, janë të kondensuara nga përvoja klinike. Duke u nisur nga qasjet dhe formalizimet e transferencës frojdiane dhe lakaniane, ne propozojmë që të përdorim pyetjet nga klinika e pjesëmarrësve për të marrë dallimin mes imagjinares dhe simbolikes, midis Unit dhe subjektit, qoftë në neurozë apo psikozë.

Myriam Mitelman

Bibliografia

- Frojdi: Rasti i Dorës
- Frojdi: Homoseksualja e re
- Lacan: Ndërhyrja në transferencë, *Les écrits.*

PROGRAMI	
08h50 - 09h00 :	Regjistrimi i pjesëmarrësve
09h00 - 09h30 :	Përshëndetje e pjesëmarrësve dhe prezantim "*Ndërhyrje mbi konceptet në psikanalizë; e pavetëdijshmja, proçeset parësore, pulsioni dhe transferenca nga Frojdi te Lacan-I"* nga **Jolka Penotet,** Presidente e Rrethit Lakanian Shqiptar
09h30 - 10h40 :	*"Nga analiza e dy raste klinike.Transferenca nga Frojdi tek Lacan*" nga **Myriam Mitelman**
10h40 - 10h50 :	*Pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit*
10h50 - 11h00 :	*Pushim - Kafe*
11h00 - 12h00 :	Vijim i konferencës nga **Myriam Mitelman**: Transferenca nga Frojdi tek Lacan tek fëmijët
12h00 – 12h30 :	Pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit.
12h30 - 13h10 :	Prezantim rasti klinik *"Dua të flas.... por fjalët nuk më dalin"* nga **Elona Hasko**
13h10 - 13h20 :	*Pushim - Kafe*
13h20 - 14h00 :	Pyetje dhe diskutime mbi rastin
14h00 - 14h40 :	Përfundime dhe perspektiva kliniko-teorike nga **Myriam Mitelman**
14h40 - 15h00 :	Plotësim i formularëve të vlerësimit e të njohurive nga pjesëmarrësit për QKEV